

Mekanizmi Koordinues Vendor, i Shqipërisë

Politika e Konfliktit të Interesit

1. Historiku dhe qëllimi

Konflikti i interesit lind atëherë kur interesat individuale apo organizative të anëtarëve të MKV-s ndikojnë ose potencialisht mund të ndikojnë në vendimmarrjen e tyre. Perceptimi i thjeshtë i konfliktit të interesit mund të dëmtojë kredibilitetin e MKV-s dhe programeve që ajo mbikëqyr. Konfliktet aktuale, potenciale ose të dukshme të interesit mund të gjenden në të gjitha organet vendimmarrëse dhe duhet të menaxhohen për të siguruar që vendimet e marra janë objektive dhe të besueshme.

Perceptimi i konfliktit të interesit në mënyrë unanime pranon se edhe gjykimi i personave më të mirë mund të çvlerësohet kur interesat e tyre, ose ato të një anëtari të familjes, një institucioni me të cilin ata janë të lidhur, ose bashkëpunojnë ngushtë, preken nga puna e tyre. MKV-ja e Shqipërisë njih dhe adreson konfliktin e interesit, jo vetëm si një kërkesë e drejtë e Fondit Global, por është i mendimit se krijimi i Politikës së Interesit do të jetë në interesin më të mirë të aktorëve kryesorë. MKV-ja, anëtarët e saj, Përfituesit kryesorë dhe Nën-përfituesit e Fondit Global, si edhe zbatuesit e programit që përfitojnë duhet të jenë të vetëdijshëm për konfliktet aktuale dhe të perceptuara të interesit. Nëpërmjet krijimit të një Politike të plotë të konfliktit të interesit, MKV-ja në mënyrë transparente mund të menaxhojë të gjitha konfliktet e interesave. MKV-ja duhet të sigurojë se aty ku lindin konfliktet e interesit, të trajtohen me shpejtësi dhe në mënyrë të drejtë.

Kjo Politikë e Konfliktit të Interesit është projektuar për tu përfituar nga anëtarët e MKV-s, punonjësit, këshilltarët dhe palët e tjera që ndërveprojnë me MKV-n për të identifikuar situatat apo rrethanat që paraqesin konfliktet e mundshme të interesit. Kjo politikë ka për qëllim të sigurojë MKV-në me procedurat e duhura për të menaxhuar në mënyrë të përshtatshme këto konflikte në përputhje me kërkesat e Fondit Global dhe ligjeve të vendit. Kjo Politikë e Konfliktit të interesit ka për qëllim promovimin e drejtësisë, përgjegjësisë dhe transparencës, duke siguruar standarde të larta të etiks së sjelljes dhe të besimit të publikut në aktivitetin e MKV-s.

2. Parimet udhëzuese

Për të nxitur transparencën, përgjegjshmërinë, gjithëpërfshirjen, dhe besimin e publikut në të gjitha aktivitetet e saj, MKV-ja e Shqipërisë do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme themelore:

- Qëllimi suprem i MKV-s është që ti shërbejë interesit të publikut;
- Aktivitetet e MKV-s duhet të promovojnë transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin e MKV-s;
- Ndërtimi i besimit të publikut është një gur themeli për qeverisjen e mirë;
- Promovimi i përgjegjësive organizative dhe individuale për çdo anëtar të MKV-s duhet të zhvillohet përmes shembullit;
- Promovimi i një kulture që është intolerante ndaj konflikteve aktuale apo të perceptuara të interesit duhet të udhëheqë MKV-n në aktivitetet e saj;
- Konfliktet e interesit duhet të menaxhohen përmes politikave dhe procedurave formale;

3. Përkufizimet

3.1 Konflikt interesi kemi në rastet kur një anëtar i MKV-s ose Sekretariati i MKV-s përdor pozitën e tij / saj për të çuar përpara ambiciet apo interesat personale, interesat e një institucioni me të cilin ai / ajo është i lidhur, të një anëtari të familjes, ose bashkëpunëtori të ngushtë, në një mënyrë që të disavantazhojë ose përjashtojë të tjerët, ose është i vendosur të dëmtojë efikasitetin e përgjithshëm të programit. (Udhëzuesi i Fondit Global dhe Kërkesat për MKV-në Qershor 2011).

3.2 "Konflikti i interesit" përfshin konfliktet e mundshme të interesit dhe konfliktet e perceptuara të interesit.

3.3 Një konflikt i mundshëm i interesit ndodh atëherë kur një anëtar i MKV-s ose Sekretariati i MKV-s është vendosur në një pozitë të tillë, në të cilën ka kapacitet për të përdorur pozitën e tij / saj ose të statusit, siç përcaktohet më lart, për tu gjendur në një konflikt interesi.

3.4 Një konflikt i perceptuar i interesit ndodh atëherë kur një person beson apo ka dyshime mbi baza të arsyeshme se një konflikt i interesit, siç përcaktohet më lart, ekziston nga ana e një anëtari të MKV-s ose Sekretariati i MKV-s.

3.5 Një bashkëpunëtor i ngushtë i një personi përfshinë një anëtar të familjes (bashkëshort, fëmijë, vëlla, prind, kushëri, krushqi), mik, partner biznesi, apo bashkëpunëtor profesional.

3.6 Një person është i lidhur me një institucion ku ai / ajo është i punësuar apo vullnetar, ka interesa financiare, një rol teknik ose qeverisës me atë institucion.

3.7 Përjashtimi ndodh kur një person e tërheq veten nga pjesëmarrja në diskutime dhe vendimmarrje, kur përmes përfshirjes së tij/saj mund të lindi një konflikt interesi.

3.8 Politika e Konfliktit të Interesit mund të lindi edhe në lidhje me dhurata, të cilat përfshijnë favore, shpërblime, ose mbështetje, qoftë të një natyre monetare ose jo-monetare.

3.9 Konfliktet e interesit mund të lindin, por nuk janë të kufizuara në rastet:

- Përzgjedhjes së Përfituesit/ve Kryesorë dhe Nën-përfituesve;
- Kërkesave të ripërtëritjes për një fazë të ardhshme të një granti;
- Një riprogramimi të konsiderueshëm të fondeve të grantit;
- Çështje që lidhen me vlerësimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e Përfituesit/ve Kryesorë dhe Nën-përfituesve;
- Diskutimin e çështjeve në të cilat anëtarët e MKV-s apo institucionet e tyre kanë një interes financiar, të tilla si kontraktimi, rekrutimi i stafit etj.

4. Zbatimi i Politikës së Konfliktit të Interesit

4.1 Konflikti i politikës së interesit aplikohet për anëtarët MKV, zëvendësit dhe stafin e Sekretariatit të MKV-s.

4.2 MKV-ja do të siguroj që për marrjen e vendit dhe të paktën një herë çdo vit, anëtarët e MKV ti nënshtrohen orientimit mbi përgjegjësitë e tyre në lidhje me konfliktin e interesave dhe kërkesave të kësaj politike.

4,3 MKV-ja delegon Komitetin Ekzekutiv si Autoritet i MKV-s për të adresuar etikën dhe konfliktin e çështjeve të interesit

4,4 MKV-ja duhet të marri parasysh pasojat e konfliktit të interesit në përbërjen e tij kur konsideron rinovimin e anëtarësimit.

5. Protokollet e Administrimit dhe Zbutjes së Konfliktit të Interesit

5.1 Deklarata statutore:

Të gjithë anëtarët e MKV-s dhe zëvendësit duhet të plotësojnë Deklaratën e Pranimit të Konfliktit të Interesit dhe Deklaratën e Politikës së Konfliktit të Interesit (Shtojca I) në kohën antarësimit në MKV dhe në atë moment të deklarojnë çdo konflikt faktik ose të perceptuar të interesit. Deklarata do të plotësohet çdo vit dhe pas kësaj do të përditësohet sipas nevojave, sa herë ndodh një ndryshim informacioni në materialin e dorëzuar. Sa herë që ndodh një ndryshim në material është përgjegjësi e anëtarit të bëjë përditësimin e deklaratës. Deklaratat do të arkivohen nga Sekretariati dhe vihen në dispozicion për inspektim, nga organi i deleguar i MKV-s, i ngarkuar me përgjegjësinë për etikën dhe konfliktin e interesit. Këto deklarata do të jetë pjesë e të dhënave publike të MKV-s.

5.2 Roli i Kryetarit dhe Nën/Kryetarit:

MKV-ja duhet të sigurojë që as Kryetari i saj dhe as Nën/Kryetari të përfaqësojnë organizata/institucione që shërbejnë si përfitues kryesor të një projekti, të iniciuar nga MKV-ja dhe të financuar nga Fondi Global. Në raste të tilla, kur Kryetari dhe Nën/Kryetari përfaqësojnë organizata/institucione që janë kandidatë për tu zgjedhur si përfitues kryesorë, atëherë do të zbatohen neni 5.4 dhe neni 5.5.

Në rastin e përzgjedhjes si Përfitues Kryesor dhe nëse, punojnë drejtpërdrejtë si pjesë e Njesisë së Zbatimit të Programit, mbajnë pozicione, apo janë titullar në të njëjtin departament / institucion ose të institucioneve në varësi të tyre, Kryetari / Nën/Kryetari do të japin dorëheqjen nga pozicionet e tyre dhe të mbajnë pozicionin e një anëtari të thjeshtë.

Nëse numri i konfliktit të mundshëm të interesit të një grupimi zgjedhor do të jetë më shumë se një, do të jetë detyrë e anëtarëve të këtij grupimi (e vendosur kjo me

konsensus midis tyre) për të vendosur të ketë vetëm një anëtar dhe të tjerët do të jepnin dorëheqjen duke pushuar së qeni anëtarë të MKV-s. Kjo është në përputhje me Kërkesat e Pranueshmërisë dhe Legjitimitetit të MKV-s të përcaktuara nga FG. Në rast të paraqitjes së një situatë të tillë që një nga Ministrinë e Qeverisë të jetë PK, në veçanti nga kjo ministri, jo më shumë se një anëtarë, do të vazhdojë të jetë një anëtar i zakonshëm.

5.3 Antarësia e Komitetit:

Nuk do të emërohet në Komitetin e Mbikëqyrjes së MKV-s, anëtarët e MKV-s që përfaqësojnë institucionet që janë Përfitues/ë Kryesor apo Nën-përfitues. Megjithatë këta anëtarë të MKV-s mund të ftohen të mbledhjet e Komitetit Mbikëqyrës për të siguruar informacion mbi grantet, si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Gjatë procesit të përzgjedhjes anëtarët e MKV-s që përfaqësojnë institucionet që janë kandidatë për tu zgjedhur si Përfitues/ë Kryesor apo Nën-Përfitues apo Nën-Nën-Përfitues nuk do të marrin pjesë në diskutime (komitete ose mbledhjeve të përgjithshme).

Nëse për shembull Ministria e Shëndetësisë apo rrjedhimisht ndonjë nga departamentet ose institucionet në varësi të drejtpërdrejtë të saj, aplikojnë për tu përzgjedhur si Përfitues Kryesor apo Nën- Përfitues / Nën-Nën-Përfitues, ata nuk do të marrin pjesë në diskutimet që do të zhvillohen gjatë procesit të përzgjedhjes. Për më shumë, në rast se subjektet janë përzgjedhur dhe janë Përfitues Kryesor të drejtpërdrejtë, ata duhet të japin dorëheqjen nga Komiteti Mbikëqyrës i MKV-s.

5.4 Njoftimi i pikave të Axhendës, Deklarimi i Konfliktit të Mundshëm të Interesit ose Perceptimi i tij:

5.4.1 Çdo anëtar i MKV-s do të marrë të paktën një javë përpara mbledhjes rendin e ditës së mbledhjes. Anëtari i MKV-s duhet të vendos nëse ka konflikt të mundshëm interesi dhe përgatitet të tërhiqet nga diskutimet në MKV. Këta anëtarë duhet të deklarojnë përpara Kryetarit natyrën e interesave të tilla. Anëtari duhet të vetëtërhiqet nga të gjitha çështjet e diskutimit dhe çdo votimi që përbën konflikt interesi; siç përshkruhet në nenin 5.8.1, Përjashtimi.

5.4.2 Në fillim të mbledhjes së MKV-s, anëtarët e MKV-s ose zëvendësit e tyre duhet të deklarojnë nëse ka konflikt interesi, pasi janë rishikuar apo miratuar të gjitha pikat e rendit të ditës.

5.4.3 Çdo anëtar i MKV-s mund të ngrejë çështjet e konfliktit të mundshëm të

interesit, para ose gjatë mbledhjes. Anëtarët mund ti paraqesin Kryetarit ose organeve të tjera të MKV-s të ngarkuar me përgjegjësinë për konfliktin e interesit, një pretendim për konflikt interesi, të cilët duhet të shqyrtojnë çdo pyetje të ngritur.

5.5 Dhurata dhe Përfitime:

5.5.1 Anëtarëve të MKV-s u ndalohet të pranojnë dhurata në rrethana, të cilat në mënyrë të arsyeshme, mund të interpretohet se, dhurata është e motivuar nga pozicioni si anëtar apo person alternativë i MKV-s dhe mund të ndikojë ndjeshëm në vendimet e MKV-s.

5.5.2 Anëtarëve të MKV-s dhe zëvendësve u ndalohet pranimi i dhuratave pa një interpretim të arsyeshëm, se dhurata nuk ka për qëllim të ndikojë në politikatat ose praktikatat e MKV-s, për Përfituesin/it Kryesor, apo ndonjë nga programet që financohen.

5.5.3 Anëtarët e MKV-s dhe zëvendësit e tyre të cilët përfaqësojnë institucionet shtetërore, korporatat, ose organizma, dhe të cilët për shkak të pozicionit të tyre janë subjekt i kodit etik apo standarteve të sjelljes, mund të pranojnë letra falenderimi për pjesëmarrjen gjerësisht në mbledhje, në të kundërt, nëse kjo politikë për pjesëmarrje të tilla nuk e lejon, bazuar në kodin etik apo standardet e sjelljes, për të cilën individi është subjekt.

5.6 Referimi i Çështjeve të Konfliktit të Interesit në Komitetin Mbikëqyrës të MKV-s

Komiteti i ngarkuar me përgjegjësinë e mbikëqyrjes është vendi më i mirë për të adresuar çështjet e konfliktit të interesit, pasi qartazi është deklaruar se anëtarët e këtij Komiteti nuk duhet të kenë asnjë konflikt interesi.

5.7 Dyshime për Konflikt Interesi:

5.7.1 Nëse nga ndonjë palë është raportuar një dyshim për konflikt interesi, Kryetari i MKV-s dhe Komiteti Mbikëqyrës përgjegjës për çështjet e konfliktit të interesit do ta shqyrtojnë çështjen menjëherë, për të përcaktuar nëse anëtari i MKV-s apo personi alternativë ka qënë korrekt në deklarimin e konfliktit e interesit dhe në qoftë se shkelja është përgjegjësia e tij ose e saj. Çështja duhet të raportohet tek të gjithë anëtarët e MKV-s. Çdo çështje thelbësore duhet të silltet për tu vendosur nga të gjithë anëtarët e MKV-s.

5.7.2 Nëse para MKV-s paraqitet një çështje për reflektim, anëtarit ose personi alternativë, do ti kërkohet të tërhiqet gjatë kohës që çështja është duke u diskutuar. Çdo anëtar i MKV-s ose person alternativë mund të paraqes ankesa për konfliktin në MKV, dhe ankesa të tilla duhet të diskutohen.

5.8 Përjashtimi

5.8.1 Në momentin kur axhenda e mbledhje ka pika të rëndësishme për të diskutuar, për të cilat ekziston konflikt interesi për një anëtar të MKV-s apo zëvendësin e tij/saj, anëtari dhe zëvendësi i tij/saj do të heqin dorë, të largohen nga salla, dhe presin në një ambjent tjetër. Anëtarët e MKV-s dhe zëvendësit që kanë konflikt interesi nuk mund të votojnë për çështjen në shqyrtim dhe nuk do të jetë të pranishëm në sallën e mbledhjeve gjatë procesit të votimit. Pas përfundimit të diskutimit dhe votimit apo çdo vendimmarrje tjetër e nevojshme të kenë përfunduar, anëtari i MKV-s ose personi alternativ, do të thirret në sallën e mbledhjes.

5.8.2 Për të siguruar informacionin e nevojshëm për anëtarësimin në MKV, anëtarët e MKV-s dhe zëvendësit e tyre, që kanë konflikt interesi, mund të thirren në sallën e mbledhjeve në funksionin si përfaqësues të organizatës së tyre. Pas përfundimit të dhënies së informacionit, ata përsëri duhet të largohen nga salla deri në një rithirrje tjetër.

5.8.3 Anëtarët e MKV-s dhe personat zëvendës të tyre nuk duhet të përpiqen të

ushetrojnë ndikimin e tyre personal, në sallën e mbledhjeve, ose jashtë saj, në lidhje me temat në diskutim.

5.8.4 Nëse Kryetari ka konflikt interesi, ai ose ajo duhet të delegojnë përmbushjen e përgjegjësisive tek Nën-Kryetari për periudhën e shqyrtimit dhe të vetë tërhiqet. Në qoftë se Nën-Kryetari ka gjithashtu konflikt interesi, Nën-Kryetari duhet gjithashtu të vetëtërhiqet dhe MKV-ja duhet të zgjedhë një Kryetar të përkohshëm që vepron për periudhën në shqyrtim, duke ndjekur një procesin tërësisht të dokumentuar.

6. Pasojat e Mosdeklarimit të Konfliktit të Interesit

6.1 Çdo person i cili ka arsye të besojë se ka një konflikt interesi nga ana e një anëtari të MKV-s, në çdo kohë mund ta paraqes me shkrim çështjen në Komitetin Mbikëqyrës së MKV-s. Komiteti Mbikëqyrës i MKV-s do të këshillojë MKV mbi të gjitha çështjet e tilla të referuara këtij Komiteti, veprimet e ndërmarra nga Komiteti Mbikëqyrës për të hetuar çështje të tilla, si dhe të gjitha rekomandimet për veprim nga ana e MKV-s. Pas pranimit të këshillave nga Komiteti Mbikëqyrës, MKV-ja do të shqyrtojë dhe votojë për çdo rekomandim nga Komiteti Mbikëqyrës në mbledhjen e ardhshme.

6.2 Nëse MKV-ja informohet se një anëtar i MKV-s ose personi alternativë ka kryer me dëshirë mosdeklarimin e konfliktit të interesit, MKV-ja do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të revokuar çdo përfitim të mundshëm. Para se të marrë një veprim të tillë, MKV-ja, informon me shkrim anëtarin ose personin alternativë mbi çështjet e konfliktit të interesit dhe tu japë anëtarit ose personit alternativë mundësinë për të dhënë shpjegime për mungesën e korrektësisë së pretenduar në deklarimin e konfliktit të interesit.

6.3 Kryetari i MKV-s duke ju referuar të gjithë informacionit të vënë në dispozicion në lidhje me konfliktin e interesit nga Komiteti Mbikëqyrës i ngarkuar me çështjet e konfliktit të interesit, do të bëjë përcaktimin e faktit nëse ekziston konflikt interesi. Në qoftë se ekziston konflikt interesi, Komiteti Mbikëqyrës do të bëjë një rekomandim të plotë për MKV-n në lidhje me veprimet

e duhura që duhet të ndërmerren në lidhje me personin i cili nuk ka qënë korrekt në deklarin e konfliktit të interesit.

6.4 Bazuar në rekomandimet e Komitetit Mbikëqyrës, MKV-ja në mbledhjen e parë, pas pranimit të vendimit dhe rekomandimeve, do të shqyrtoj dhe votoj.

6.5 Në bazë të rekomandimeve dhe pas votimit në MKV, arsyet dhe anëtari ose personi alternativë i MKV-s duhet të raportohen në grupimin zgjedhor të anëtarësisë. Nga grupimi legjitim do të kërkohet që të bëhet zëvendësimi i menjëhershëm i anëtarit ose personit alternativë që përfaqësohet në MKV .

6.6 MKV-ja do të raportojë të gjitha rastet e situatave të konfliktit të interesit që janë në shkelje flagrante të çdo ligji operativ deri organet zyrtare përkatëse qeveritare përgjegjëse për zbatim.

7. Dokumentimi i Konfliktit të Interesit

Të gjitha vendimet që lidhen me konfliktin e interesit do të regjistrohen nga MKV-ja dhe do raportohen në procesverbalin e mbledhjes. Dokumentimi do të konstatojë:

- Në natyrën dhe shkallën e konfliktit
- Një përmbledhje të diskutimit
- Veprimet e ndërmarra për të menaxhuar konfliktin.

8. Orientimi i Politikave të Konfliktit të Interesit

MKV-ja do të sigurojë që të paktën një herë në çdo vit anëtarët e MKV-s ti nënshtrohen trajnimit mbi përgjegjësitë e tyre në lidhje me konfliktin e interesave dhe kërkesave të kësaj politike.

Pranimi i Politikave të Konfliktit të Interesit

Emri i Anëtarit/es të MKV-s/Alternativë:

Institucioni: _____.

Pozicioni: _____

Grupi qe perfaqeson _____

Unë, i nënshkruari, me anë të këtij deklarami. zotohem se do të jem në përputhje me Politikën e Konfliktit të Interesit të MKV-s së Shqipërisë bashkëngjitur.

Si anëtar i MKV-s apo zëvendësues, unë nuk do të marr pjesë në diskutime, jap rekomandime, marr vendime, apo procese të tjera në të cilat unë kam konflikt interesi, apo një konflikt të mundshëm interesi, siç përcaktohet në Politikën e Konfliktit të Interesit bashkëngjitur.

Unë do të plotësoj Seksionin 2 të këtij dokumenti në lidhje me përkatësitë e mia profesionale dhe personale. Unë premtoj të deklarojë konfliktin tim të interesit në antarësisë së përgjithshme të MKV-s para ose në fillim të çdo Mbledhje të MKV-s në të cilën do të merren në konsideratë çështje të rëndësishme. Unë do të konstatojë natyrën e konfliktit të interesit dhe të gjitha faktet përkatëse që kanë të bëjnë me interesin tim. Unë do të vetëpërrjashtohem nga pjesëmarrja në çdo procedurë që ka lidhje me çështjen.

Nëse një person pretendon se unë kam konflikt interesi, unë do të përgjigjem për këtë akuzë dhe do të veprojë në përputhje me vendimin e marrë nga MKV-ja.

Nëse kam arsye për të besuar se një person ka konflikt interesi në lidhje me çdo çështje, të krijuar nga roli apo përgjegjësia e tij/saj në MKV, unë do të raportoj mendimin tim dhe informacionin mbi të cilin bazohet tek Kryetari, i cili bazuar në kërkesën dhe aftësitë e mia do të ofrojë informacion të mëtejshëm. Unë marr përsipër të deklaroj konfliktin e interesit, në mirëbesim, bazuar në një besim të sinqertë se konflikti apo konfliktet e tilla mund të rrezikojnë transparencën, përgjegjshmërinë, gjithëpërfshirjen ose intersat publike në MKV-s.

Në rast të ndonjë pyetjeje, paqartësie apo nevojë për sqarime në të kuptuarit në përputhje me Politikën e Konfliktin e Interesit, për të më asistuar dhe ndihmuar do të kontaktojë Kryetarin e MKV-s ose Sekretariatit e MKV-s.

Vërtetoj me anë të kësaj, se kam marrë një kopje, dhe jam informuar me Politikën e Konfliktit të Interesit të MKV-s së Shqipërinë.

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Nënshkrimi i Deklaratës së Interesit

Ju lutemi përgjigjuni plotësisht pyetjeve të mëposhtme. Pasi ta përfundoni nënshkruajeni.

Nr.	Pyetje	Përgjigje
1a.	Ku punoni? (listoni perfshirjet tuaja edhe ne rast te me shume se nje institucioni)	
1b.	Çfarë pozicioni mbani?	
2.	A jeni anëtar i Bordit të Drejtorëve të një organizate? Nëse po, ju lutemi listoni organizatën (tat).	
3.	A jeni pronar, bashkë-pronar, ose zotërues aksionesh të një biznesi privat? Nëse po, ju lutemi listojini.	
4.	A merrni kompensime (tarifa të reduktuara, paga shtesë etj) nga aktivitete të financuara nga Fondi Global në Shqipëri?	
5.	A është apo planifikon ndonjë nga organizatat e listuara më sipër, si përfitues kryesor apo nën-përfitues i granteve të Fondit Global? Nëse po, ju lutemi listoni organizatën dhe grantin.	
6.	A është apo planifikon ju apo ndonjë anëtar i afërt i familjes që punon për /apo ka interesa pasurore në një organizatë që është përzgjedhur si përfitues kryesor ose nën-përfitues i granteve të Fondit Global? Nëse po, ju lutem shënoni emrin e personit, organizatën, dhe programit e cilës sëmundje i përket.	

7.	A keni shërbyer në Komitetet e MKV-s? Nëse po, ju lutem i listoni dhe identifikoni nëse keni rol udhëheqës në komitet (Kryetar, bashkë-Kryetar, etj)	
8.	A janë në konflikt ose kanë potencial për konflikt me strategjinë kombëtare të sëmundshmërive për HIV/AIDS dhe TB, misioni apo politika e organizatës ku ju punoni? Nëse po, për cilat sëmundje dhe si?	
9.	Ju lutemi listoni ndonjë përkatësi apo situatë tjetër që besoni se mund të përbëjë konflikt interesi për ju.	

Nënshkruar nga: _____

Data: _____

Deklarata e Konfliktit të Interesit

Unë, _____ (emri) jam dakord me nënshkrimin e mëposhtëm se i emëruar në pozicionin e _____ dhe zotohem të jem në përputhje me Politikën e Konfliktit të Interesit të Mekanizmit Koordinues Vendor të Shqipërisë për Fondin Global për të luftuar HIV / AIDS –in dhe Tuberkulozin.

Si _____ (emri i pozicionit) nuk do të marrë pjesë në diskutime, të jap rekomandime apo të marr vendime, apo procese të tjera në të cilat kam konflikt interesi, një konflikt të mundshëm interesi, bazuar në njohuritë më të mira që kam për një konflikt të perceptuar interesi, siç përcaktohet në politikën e konfliktit të interesit bashkangjitur.

Nëse unë besoj se kam një konflikt interesi, një konflikt të mundshëm interesi, apo një konflikt të perceptuar të interesit në lidhje me një çështje që krijohet për shkak të pozicionit tim si _____ (emri i pozicionit), atëherë unë marr përsipër të ofroj paraprakisht të gjitha faktet përkatëse në fillim të Mbledhjes së MKV-s, ose paraprakisht në çdo Mbledhje të MKV-s, në të cilën çështja duhet të merret në

konsideratë. Unë do të konstatojë natyrën e konfliktit të interesit dhe të gjitha faktet përkatëse që kanë të bëjnë me interesin tim. Atëherë unë do heq dorë në mënyrë të vullnetshme nga pjesëmarrja në çdo procedurë në lidhje me çështjen.

Nëse një person pretendon se unë kam një konflikt interesi, një konflikt të mundshëm interesi, apo një konflikt të perceptuar të interesit në lidhje me një çështje që krijohet nga pozicioni im i _____: _____ (emri i pozicionit) unë do të ofroj paraprakisht të gjitha faktet përkatëse tek Kryetari i MKV-s, Komiteti Mbikqyrës dhe Sekretariati i MKV-s, dhe do t'i bindem çdo vendimi të marrë nga MKV-ja e Shqipërisë në lidhje me konfliktin e dyshuar të interesit.

Nëse kam arsye për të besuar se një person ka konflikt interesi në lidhje me çdo çështje që lidhet me rolin dhe përgjegjësinë e tij në MKV-s apo ndonjë forum i lidhur me të, unë do të raportoj në mirëbesim informacionin mbi të cilin është bazuar, tek Kryetari i forumit përkatës, duke ofruar informacionet e kërkuara prej meje nga Kryetari i forumit përkatës, në përputhje me kompetencat e mia. Unë marr përsipër të deklaroj konfliktin e interesit, në mirëbesim, bazuar në një besim të sinqertë se konflikti apo konfliktet e tilla mund të rrezikojnë transparencën, përgjegjshmërinë, gjithëpërfshirjen ose interesat publike në MKV ose të forumeve të tjera të lidhura me të. Unë e kuptoj se me marrjen e një raporti të tillë, është e drejta ime për të kërkuar që identiteti im të jetë i mbrojtur në mënyrën më të plotë të mundshme, dhe se është obligim i MKV-s dhe forumeve të ngjashme me të ta respektojnë këtë të drejtë.

Nëse unë kam ndonjë pyetje apo nevojë për ndihmë në të kuptuarit dhe të vepruarit në përputhje me politikën e Konfliktin të Interesit, unë do të kontaktoj Kryetarin e MKV-s ose Sekretariatit e MKV-s ,që do më ndihmojnë me pyetjet dhe interpretimet dhe do të ofrojnë rekomandimet e nevojshme përkatëse nëse ekzistojnë apo jo për të justifikuar veten nga pjesëmarrja në procedurën/at përkatëse. Unë kuptoj se kam të drejtën për t'u asistuar me një përgjigje me shkrim për çdo pyetje apo kërkesë të dorëzuar.

Emri i Deklaruesit: _____

Pozicioni: _____

Firma e Deklaruesit _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____